REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË/MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE
Nr.Br.No: 01-1330/3
Data/Datum/Date: 26/11/2026
Shtojca/Dodaci/Annexi -2-
PRISHTINË/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë – Ured Ministarke Pravde – Office of the Minister of Justice

---

Nr. 312/2026
Datë: 26/11/2026

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura në përputhje me nenin 10, nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi1.5) të Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 35 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtaret Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-294 për Zyrtaret Publik dhe nenin 53 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe në pajtim me nenin 6 të Rregullores (QRK)-Nr.08/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Zëvendëskryeministrja dhe Ministrja e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Znj. Zyle Gojnovci, Avokate Shtetërore në Avokaturën Shtetërore, në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, caktohet ushtruese e detyrës së Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror.

2. Ushtruesja e detyrës, e caktuar sipas pikës 1 të këtij vendimi, obligohet që detyrat dhe përgjegjësitë e saj t'i ushtrojë në pajtim me legjislacionin në fuqi.

3. Obligohet Avokatura Shtetërore për zbatimin e këtij vendimi.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet Vendimi nr. 73/2026, i datës 28.04.2026, për caktimin e ushtruesit të detyrës së Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror.

5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe mbetet në fuqi deri në emërimin e Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror, por jo më gjatë se dymbëdhjetë (12) muaj.

A r s y e t i m

Pas paraqitjes së dorëheqjes nga znj. Fitore Gajtani, ushtruese e detyrës së Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror, si dhe duke marrë parasysh nevojën për ngritjen e nivelit të performancës institucionale, forcimin e llogaridhënies dhe përgjegjësisë menaxheriale, është vlerësuar e domosdoshme ndërmarrja e masave organizative dhe menaxheriale për garantimin e vazhdimësisë së udhëheqjes dhe përmirësimin e funksionimit të Avokaturës Shtetërore.

Duke pasur parasysh rolin dhe rëndësinë e Avokaturës Shtetërore në përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave juridike, pasurore dhe financiare të institucioneve shtetërore në procedurat gjyqësore, të ndërmjetësimit dhe të arbitrazhit, prioritet mbetet rritja e efikasitetit në trajtimin e lëndëve, përmirësimi i cilësisë së përfaqësimit juridik, respektimi i afateve procedurale, forcimi i

mekanizmave të kontrollit dhe mbikëqyrjes së brendshme, si dhe ngritja e nivelit të përgjegjësisë dhe llogaridhënies në të gjitha strukturat organizative të këtij institucioni.

Në këtë drejtim, caktimi i përkohshëm i zëvendësuesit të Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror synon, përveç garantimit të vazhdimësisë institucionale, edhe përmirësimin e matshëm të performancës institucionale, avancimin e standardeve të menaxhimit, forcimin e disiplinës organizative dhe sigurimin e një sistemi efektiv të raportimit, monitorimit dhe llogaridhënies, me qëllim të mbrojtjes sa më efektive të interesave juridike dhe financiare të Republikës së Kosovës.

Në përputhje me nenin 21 të Ligjit Nr. 08/L-227 për Përfaqësimin e Institucioneve Shtetërore në Procedura Gjyqësore, Ndërmjetësim dhe Arbitrazh, si dhe në kuadër të kompetencave ligjore të Ministres së Drejtësisë, është vlerësuar i nevojshëm caktimi i përkohshëm i zëvendësuesit të Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror, deri në emërimin e Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Andaj, bazuar në legjislacionin përkatës në fuqi dhe në arsyet e lartcekura, është vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Donika Gërvalla - Schwarz

Zëvendëskryeministre dhe Ministre e Drejtësisë

Vendimi u dërgohet:

- *Znj. Zyle Gojnovci;*
- *Znj. Fitore Gajtani;*
- *Kabinetit të Zëvendëskryeministres dhe Ministres së Drejtësisë;*
- *Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Avokaturës Shtetërore;*
- *Departamentit për Buxhet dhe Financa;*
- *Divizionit për Burime Njerëzore;*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.*